



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNO-SNAZHA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROSEVAC

28-01-2019 Pjona

Më
Dana

08.02.2019

C.nr.1132/18

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtarja Milinda Bytyqi-Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit [REDACTED]
[REDACTED] nga Ferizaj rr' [REDACTED] të cilin me autorizim e përfaqëson [REDACTED]
avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna Ferizaj- Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson [REDACTED], në çështjen juridike pagesa e pagave përcjellëse dhe jubilare, në prezencën e të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarit të paditurës, në shqyrtimin kryesor të mbajtur me datë 22.01.2019 morri këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht kërkesë padia e paditësit [REDACTED] nga Ferizaj rr'
[REDACTED], si e bazuar.

II. DETYROHET e paditura që paditësit ti paguaj shumën e përgjithshme prej 1,815.68 € (një mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë euro e gjashtëdhjetë e tetë cent), dhe atë në emër të tri pagave përcjellëse shumën prej 1,361.76 € (njëmijë e treqind e gjashtëdhjetë e një euro e shtatëdhjetë e gjashtë cent) si dhe një pagë jubilare në shumë prej 453.92 € (katërqind e pesëdhjetë e tri euro e nëntëdhjetë e dy cent).

III. REFUZOHET pjesa tjeter e kërkesë padisë përtej asaj që është vendosur si në pikën II të dipozitivit në shumën prej 214.62 € si e pa bazuar.

IV. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia paguaj shumën si në pikën II të dipozitivit në lartësi prej 1,815.68 € (një mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë euro e gjashtëdhjetë e tetë cent), dhe atë në emër të tri pagave përcjellëse shumën prej 1,361.76 € (njëmijë e treqind e gjashtëdhjetë e një euro e shtatëdhjetë e gjashtë cent) si dhe një pagë jubilare në shumë prej 453.92 € (katërqind e pesëdhjetë e tri euro e nëntëdhjetë e dy cent), me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë dt.19.11.2018, deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzime e procedurës në shumë prej 269 € të gjitha brenda afatit prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi [REDACTED] nga Ferizaj rr' [REDACTED] 'me datë 19.11.2018, përmes të autorizuarit të tij av. [REDACTED] ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Ferizajt- Drejtoria e Arsimit për pagesën e tri pagave përcjellëse dhe një page jubilare pas pensionimit.

I autorizuari i paditësit në seancën e mbajtur me datën 22.01.2019 ka theksuar se mbetet në tërsi pranë kërkesëpadisë dhe ka deklaruar se kërkon nga Gjykata që ta detyrojë të paditurën komuna e Ferizajt- Drejtorinë e Arsimit në Ferizaj që paditësit në emër të tri pagave përcjellëse pas pensionimit të ia paguaj shumën e të hollave prej 1.522.80 €, kurse sa i përket pagës jubilare kërkojmë të paguaj shumën prej 507.60 €, pra t'i ia paguaj paditësit shumën e përgjithshme 2.030.40 €.

I kërkon shpenzimet e procedurës për seancë gjyqësore 135 €, hartimin e padisë shumën prej 104 € si dhe taksën për padi shumën prej 30 €.

I autorizuari i të paditurës ka kundërshtuar në tërsi kërkesëpadinë e paditësit, ka deklaruar se nga provat e administruara dhe vlerësimet e tyre kanë konstatuar se kërkesëpadia e paditësit lidhur me shumën e pagave jubilare dhe përcjellëse nuk është në korrelacion të drejtë për listën e pagave jubilare dhe përcjellëse, nga kjo bazë dhe nga theksimeve e mëparshme kanë ardhur deri te përfundimi logjiko juridik se kërkesë padia është e pajustifikueshme dhe e pa bazuar ngase në bazë të provave që ekzistojnë në shkresat, sipas listave të pagave është konstatuar se paditësi për muajin nëntor 2017 ka realizuar pagën prej 453.92 €, muajin dhjetor 2017 pagën prej 453.92 €, ndërsa për muajin janar 2018 pagë prej 264.43 €, gjithashtu ka bërë precizimin e padisë sepse sa i përket pagës jubilare sipas kontratës kolektive nen 35 pika 8 konstatojmë se paga bazë e mësimdhënësve në shkollat fillore është 421.20 €, për të gjitha këto që u theksuan i ka propozuar gjykatës ta refuzoj kërkesëpadinë si të pa bazuar.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes kontestimore, për aq sa palët ndërgjygjëse përbushin detyrimin e tyre për ti parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, ka administruar provat si vijon: *Padia C.nr.1132/18 e datës 19.11.2018, përgjigja në padi e datës 17.12.2018, kontrata e punës për paditësin me*

nr.310/I të datës 01.03.2015, vendimi për pensionimin për paditësin e dt.25.09.2018 me nr.1502; vërtetim i DKA për përvojën e punës nga SHMU "Afërdita " i datës 26.12.2017, vërtetim i DKA për përvojën e punës nga SHMU "Afërdita " m nr.56 i datës 05.12.2017, vendimi për njohjen e së drejtës për pensionim i datës 16.03.2018, pengu mbi pagën i datës 14.11.2016, libreza e punës me nr.19100, Vërtetimi nga SHMU "Muhammed Shemsedini"- Fshati i Vjetër me nr. protokolli 623 i datës 16.11.2018, listat e pagave për 3 muajt e fundit.

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesë padia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Gjykata nga provat e administruara ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk është kontestuese në mes palëve se paditësi për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension deri sa ishte në marrëdhënie pune tek e paditura.

Me leximin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënieς së punës të datës 26.09.2018 gjykata ka konstatuar se paditësit ju është ndërprerë marrëdhënia e punës me arritjen e moshës së pensionimit. Me leximin e librezës së punës për paditësin, gjykata ka konstatuar se paditësi ka përvojë të punës mbi 30 vjet, me leximin e listave të pagave për muajt mars, prill, dhe maj 2017, gjykata ka konstatuar se paditësi në tre muajt e fundit ka realizuar mesatare e pagës në shumë prej 453.92 €.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë për pagesën e tri pagave përcjellëse për pension, është bazuar në faktin se me kontratën kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga të dy palët dhe në nenin 49 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët ndërsa zbatohet prej 18.04.2017.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkretë paditësi e ka shfrytëzuar një të drejtë pasi që i njëjtë përfiton nga kjo kontratë përfakti se me rastin e daljes së tij në pension kontrata kolektive ka qenë në fuqi e cila nuk është kontestuar as nga e paditura.

Gjykata me rastin e përcaktimit të lartësisë të tri pagave për përcjellje në pension në shumën prej 1,361.76 € (njëmijë e treqind e gjashtëdhjetë e një euro e shtatëdhjetë e gjashë cent) si dhe një pagë jubilare në shumë prej 453.92 € (katërqind e pesëdhjetë e tri euro e nëntëdhjetë e dy cent) ka marr për bazë listën e pagave të nënshkruara nga paditësi ku shihet se paga mujor e tij ka qenë 453.92 €.

Në nenin 35 par.8 pika 8.1, 8.2, 8.3 dhe 8.4 të Kontratës kolektive për të punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm është përcaktuar që punëtori ka të drejtë në shpërblim jubilar për 10 vjet të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë prej 50% të një page bazë, për 20 vjet të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë prej 75%, të një page bazë, për 30 vjet të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë prej një pagë bazë, për 40 vjet përvojë punës te punëdhënësi i fundit në vlerë prej 150% të një page bazë, punëdhënësi i fundit është ai që i paguan shpërblimet jubilare, kurse në nenin 35 par.8 pika 8.6 parashihet se shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit, të çdo viti.

Gjykata me rastin e njohjes së një page jubilare (një page bazë) shumën prej 453.92 € është bazuar edhe në faktin se e paditura ka pasur për obligim sipas nenit 35 par.8 pika 8.6 që pagën jubilare t'ia qet me rastin e 7 marsit e të cilën nuk e ka bërë pasi që rezulton se paditësi ka dal në pension me dt.18.05.2018.

Kurse sa i përket pagave përcjellëse gjykata duke u bazuar në nenin 35 par.9 të kontratës kolektive ku thuhet punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut), që dalin në pension përfitojnë pagën përcjellëse në lartësi prej tri pagave të mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit, dhe pika 9.1 ku thuhet se pagat përcjellëse paguhën nga punëdhënësi i fundit, dhe jo më larg se 30 ditë nga dita e pensionit, e nga provat material rezulton se e paditura nuk e ka përbushur këtë detyrim të cilën e ka pasur sipas kësaj kontrate.

Gjykata sa i përket refuzimit të pjesë tjetër të kërkesëpadisë e ka refuzuar pasi që me kontratën kolektive në nenin 35 par.8, e cila ka hyrë në fuqi me datën 18.04.2017, pas administrimit të provave dhe nga deklarimet e palëve ndërgjyqësore është vërtetuar se paditësi ka përvojë të punës mbi 30 vite, dhe sipas kontratës kolektive neni 8 pika 8.3 përcakton se për 30 vite përvojë pune i takon shpërblimi jubilar në vlerë të një page bazë që në rastin konkret gjykata ka vlerësuar se paditësit i takon shuma prej 453.92 €.

Nga shiqimi i listës së pagave vërtetohet se paditësi shumën prej 453.92 € ka marrë pagë neto dhe për këtë arsy e gjykata mesataren e pagës bazë e ka llogaritur shumën prej 453.92 €.

Sa u përket pretendimeve të të paditurës se e paditura nuk ka marrëdhënie kontraktuale me paditësin për pagimin e tri pagave për përcjellje në pension dhe asaj jubilare, gjykata ka gjetur se pretendimet e të paditurës lidhur me këtë çështje janë të pa bazuara, pasi që nga kontrata kolektive respektivisht neni 2 pika 1.2 është paraparë që dispozitat e kësaj kontrate janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komuna-DK, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj), andaj gjykata lidhur me këtë çështje ka gjetur se një pretendim i tillë është i pa bazuar.

Gjykata në lartësinë e aprovuar të kompensimit të një page jubilare dhe tri pagave përcjellëse në pension, paditësit i ka njojur të drejtën në kamatës nga dita e paraqitjes padisë deri në pagesën definitive në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452.1 të LPK-së, dhe ka obliguar të paditurën që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 269€, dhe atë 104 në emër të përpilimit të padisë, për një seancën shumën prej 135 € si dhe në emër të taksë gjyqësore shumën prej 30 €.

Nga sa u tha më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL

C.nr.1132/18 dt.22.01.2019



KËSHILLA JURIDIKE, Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit, Gjykates së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.